



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG

Numri i lëndës: 2021:231022

Datë: 02.04.2024

Numri i dokumentit: 05533552

P.nr.297/21

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEGA ISTOG - Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari i vetëm gjykues Petrit Nrecaj, me sekretaren juridike Hale Ademaj, në çështjen penale ndaj të pandehurit A.M për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par. 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (tutje KPRK), i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë PP.II.nr.1805/21 të datës 13.10.2021, duke vendosur lidhur me kërkesën prokurorisë, për dhënien e urdhrin ndëshkimor, jashtë seancës me datë 02.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Pejë PP.II.nr.1805/21 të datës 13.10.2021, për dhënien e urdhrin ndëshkimor – dënim me gjobë, andaj gjykata konform nenit 495 të Kodit të Procedurës Penale (tutje KPP), jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I pandehuri:

A.M i lindur me datë ... ne fshatin O. ku dhe banon, rr. Nazmi Muzlija” Komuna I., po ashtu me vendbanim të edhe në shtetin e Francës, Paris, qyteti Colombes, Rr. “nr.17, august renuar 92700”, nga i ati I. dhe e ëma Sh., i martuar, i punësuar, me gjendje të mesme ekonomike, me numër personal ... shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Më parë e deri më datë 19.01.2021, në shtëpinë e tij në fshatin O., Komuna I., përmes mënyrave tjera, siguron shërbime për të cilat dihet se mundësohen vetëm në shkëmbim të kompensimit dhe shmang pagesën për shërbime të tilla, në atë mënyrë që, në shtëpinë e të pandehurit në adresën e lartshënuar, nga zyrtarët e KEDS-it, është hasur i kyçur direkt në rrjetin elektrik (jashtë pikës matëse) e ne kaset tokësore pa njehsor elektrik duke anashkaluar me këtë veprim njehsorin elektrik me nr.75482033 DPE 9068822, ku është konstatuar se i njëjti ka shfrytëzuar energjinë elektrike në mënyrë të paautorizuar duke i shkaktuar kompanisë KEDS dëmin në vlerë prej 345.06 euro.

- me këtë ka kryer vepër penale **vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par. 1 të KPRK-së.**

Gjykata duke u bazuar në nenin e lartcekur të veprës penale dhe neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 43, 47 dhe 48 të KPRK-së, si dhe neneve 495 dhe 369 të KPP-së, të pandehurin e:

GJYKON

- I.** Ashtu që, të pandehurit **A.M**, i shqiptohet dënim me gjobë në shumë prej treqind (300) euro, *i cili dënim me gjobë do të jetë i kushtëzuar, nuk do të ekzekutohet* nëse i pandehuri brenda periudhës së verifikimit në kohëzgjatje prej një (1) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale.
 - **Në të kundërtën**, nëse i pandehuri brenda periudhës së lartcekur të verifikimit kryen vepër tjetër penale, atëherë gjykata në bazë të nenit 50 të KPRK-së, do t'a revokon dënimin me kusht dhe ndaj personit të dënuar do të ekzekutohet dënimi me gjobë, ashtu që, do të shqiptohet dënimi për veprën penale të kryer më parë dhe veprën penale të re.
- II.** Gjykata, të pandehurit i shqipton edhe dënim plotësueses, **urdhër për kompensimin e dëmit, ashtu që, URDHËROHET** i pandehuri **A.M**, që pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në afat prej 15 ditësh, **të dëmtuarës kompanisë KEDS, distrikti në Pejë**, të i'a kompensoj dëmin e shkaktuar me vepër penale në shumë prej **treqind e dyzet e pesë euro e gjashtë cent (345.06) euro.**

III. OBLIGOHET i pandehuri që ti paguaj shpenzimet e procedurës, në emër të paushallit gjyqësor te paguaj shumën prej **njëzet (20) euro**, si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit të paguaj shumën prej **njëzet (20) euro**, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

IV. Pala e dëmtuar: *Kompania KEDS, Distrikti në Pejë, nuk udhëzohet në kontest juridiko-civil, për realizimin e dëmit.*

A r s y e t i m

Në këtë gjykatë, Prokuroria Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.1805/21 të datës 13.10.2021, me kërkesë për dhënien e urdhrit ndëshkimor, kundër të pandehurit A.M për shkak të veprës penale, vjedhja e shërbimeve, nga neni 314 par. 1 të KPRK-së.

Gjykata me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes, konform nenit 493 të KPP-së, gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 495 të KPP-së, dhe pranoi kërkesën e prokurorisë për dhënien e urdhrit ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kjo gjykatë ka vërtetuar se nga provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës, si:

Procesverbali me numër 2163457 e datës 11.03.2021;

Procesverbali me numër 2194214 e datës 19.01.2021;

Fatura mbi dëmin e shkaktuar DPEHP2116160 e datës 15.03.2021;

Foto-dokumentacion nga vendi i ngjarjes te datës 19.01.2021.

Të njëjtat, janë prova të pranueshme dhe të besueshme, mbi bazën e të cilave vërtetohet se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Gjykata duke bazuar në prova të lartcekura, vërtetoi faktin se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë të gjitha elementet e veprës penale të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, nuk ka rrethana që e përjashtojnë përgjegjësinë penale të pandehurit, nuk ka kaluar afati i parashkrimit të ndjekjes penale dhe se nuk ekzistojnë rrethana tjera të cilat e pengojnë ndjekjen penale. Prandaj e shpalli fajtor dhe e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi për dënimin plotësues

Gjykata duke vepruar konform dispozitave ligjore të nenit 59 par.1, 2 nënpar.2.2 dhe nenit 61 të KPRK-së, të pandehurit i shqiptoi dënimin plotësues urdherin për kompensimin e dëmit të shkaktuar me kryerjen e veprës penale, për faktin se pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, ka rezultuar se shuma e dëmit i cili i është shkaktuar të dëmtuarës ka qenë e përcaktuar në tërësi.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës dhe paushallit gjyqësor u mor konform nenit 450 par. 1 dhe 2, nën-par. 2.6 të KPP-së, ndërsa vendimi për pagesën për fondin për kompensimin e viktimave të krimit u mor konform Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi për kërkesat pasurore-juridike

Meqenëse me dënimin plotësues si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, është urdhëruar që palës së dëmtuar t'i bëhet kompensimi i dëmit të shkaktuar nga i pandehuri me vepër penale. Si dhe pala e dëmtuar nuk kishte ndonjë kërkesë tjetër pasurore. Andaj si rrjedhojë nuk u udhëzua në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të neneve 495 dhe 369 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEGA ISTOG

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

Sekretarja juridike,
Hale Ahmetaj

GJYQTARI,
Petrit Nrecaj

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij urdhëri ndëshkimor, i pandehuri apo mbrojtësi i tij mund të paraqesin kundërshtim në afat prej 8 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, në këtë gjykatë.

Pas kalimit të afatit për kundërshtim, kur kundërshtim nuk paraqitet, urdhri ndëshkimor merr formën e prerë dhe përfundon kjo procedurë penale.